Живот со Предизвици / Jeta me Sfida / Life With Challenges

Fibroza pulmonale idiopatike

Çka paraqet fibroza pulmonale idiopatike?



Fibroza pulmonale idiopatike (ang. Idiopathic pulmonal fibrosis – IPF) paraqet një sëmundje të rallë, ireverzibile dhe vdekjepruese e cila shkakton dëmtim të përhershëm te mushkërive nëpërmjet formimit progresiv të plagëve (indi lidhor)

Kjo sëmundje është më vdekjepruese se sa shumica e sëmundjeve të llojllojshme malinje, duke përfshirë edhe kancerin në gji, kancerin në prostate, disa forma të leukemisë dhe limfomit. Mesatarisht, gjysma e pacientëve me IPF jetojnë 2 deri në 5 vite pasi që është konfirmuar dijagnoza. Hulumtimi i fundit i cili bën krahasimin e IPFs me disa lloje të sëmundjeve malinje ka treguar që vetëm pacientët me kancer në mushkëri dhe pankreas kanë prognozë më te keqë dhe ratë më të ulët per mbijetim ne krahasim me IPF.

Gjatë IPFs formohen plagë ne indin e mushkërive të cilat e ndalojnë funksionimin normal të mushkërive, duke ndaluar zgjërimin e tyre të duhur, gjë që rezulton me zvogëlimin e sasisë të oksigjenit ne gjak. Kjo gjendje shkakton dëmtim funksional.

Shkaqe dhe faktorë te rezikut për paraqitjen e IPFs

Shkaku për paraqitjen e IPF ende nuk është i njohur, por megjithatë, disa prova sugjerojnë që faktorët gjenetik mund të kenë rol në zhvillimin e sëmundjes, kurse 5% te pacientëve me IPF kanë familijarë që e kanë këtë sëmundje. Faktorë të tjerë përfshijnë:

- Pirjen e duhanit (në të kaluarën ose për momentin)
- Ekspozimi profesional drejt disa llojeve të pluhurit

- Infeksionet virale
- Sëmundje e refluksit gastroezofageal
- Faktorë të tjerë të mjedisit jetësor

Epidemiologjia

- Në SHBA ka reth 100.000 persona me këtë sëmundje, në Europë reth 110.000 persona, kurse çdo vjet reth 35.000 pacientë të rij dijagnostifikohen vetëm në Europë. Në Republikën e Maqedonisë se Veriut nuk është i njohur numri i personave me këtë sëmundje, por mendohet që ka më shume se 15 persona me IPF.
- IPF më shpesh paraqitet tek meshkujt se sa tek femrat dhe më së shpeshti paraqitet tek persona më të vjeter se 45 vjet, mosha mesatare është 65,11 vjet.

Simptome

Ashtu siç zgjërohen plagët në mushkëri, frymëmarja është më e rënde. Shumica e aktiviteteve të rëndomta gjatë ditës fillojnë te paraqesin problem, e në disa raste pacientet as nuk mund ti kryen edhe aktivitetet më të rëndomta ditore.

Simptomet e hershme te IPF më së shpeshti përfshijnë:

- Kollitje e cila nuk zhduket
- Mungesë në frymëmarje gjatë aktiviteteve të perditshme fizike siç është hypja nëpër shkallë e ndonjëherë edhe gjatë pushimit
- kërcëllitje bilaterale inspiratore që dëgjohen gjat auskultimit të gjoksit, të përshkruajtura si të ashtuquajtur tinguj Velcro

Simptomet e vonshme të IPF mund të përfshinë:

- Mungesë të frymes dhe/ose kollitje gjatë pushimit, të cilat ndikojnë mbi aktivitetet e përditshme siç janë të ushqyerit, bisedat telefonike apo kryerja e dushit.

Simptomet e pakontrolluara të kollitjes janë të turpshme dhe shqetësuese, dhe shpesh herë i ndalojnë personat me IPF ti kryejnë aktivitetet që ato duan ti kryejnë.

Progredimi i IPFs është i ndryshëm tek çdo pacient. Disa prej tyre përjetojnë progredim të shpejtë dhe "sulme në mushkëri" që rezultojnë me hospitalizim. Të tjerë, nëse menjëherë fillojnë me tretman pasi të jenë dijagnostifikuar me IPF, jetojnë shumë më gjatë me më pak përkeqësime dhe nevojë për hospitalizim.

IPF më së shpeshti i afekton mushkërite, por në fund mundet që gjithashtu të shkaktoj edhe dobësi të zemrës ose efekte serioze mbi organet e tjera vitale.

Dijagnoza

Merëndësi është të vërtetohet dijagnoza e IPFs sa më heret, ashtu që tretmani mund të filloj sa më shpejtë. Kjo dukuri mundet të ketë ndikim signifikant mbi menyrën si progredon sëmundja.

Kollitja permanente dhe kërcellitjet karakteristike gjatë frymëmarjes si rezultat i sëmundjes, shpesh herë nuk janë te njohura si IPF. Gjysma e personave me IPF, fillimisht janë gabimisht të dijagnostifikuar, pasiqë simptomet shpesh herë ngatërohen me sëmundje të tjera të mushkërive dhe zemrës, siç është astma, sëmundja kronike obstruktive e mushkërive apo dobësia e zëmres.

Vërtetimi i dijagnozës përfshin ekskludimin e të gjitha shkaqeve të tjera të njohura për sëmundje fibroze të mushkërive dhe mund të përfshij një apo më shumë te kritereve në tekstin e më poshtëm:

- Historia medicinale dhe egzaminimi fizik
- Rentgen i gjoksit
- Testim i frymëmarjes
- Tomografi kompjuteristike
- Biopsi të mushkërive
- Bronhoskopi

Për gjysmën e pacientëve me IPF, është i nevojshëm më së paku një vit deri sa të fitohet dijagnoza e saktë. Ky period është mjaft kritik, pasiqë pa tretman, sëmundja përkeqësohet dhe me kalimin e kohës mundet që shumë shpejtë të progredojë.

Tretman

60% i personave të dijagnostifikuar me IPF nuk fillojnë menjëherë me tretman, ose nuk e fitojnë tretmanit më të mirë që është ne dispozicion. Pacientët të cilët ndoshta do të fitojnë tretman për IPF janë më së shpeshti pacienti në fazat më të avancuara të sëmundjes gjatë të cilave funksioni i mushkërive dhe kualiteti jetësor jane shumë të dëmtuar.

Për momentin, zgjidhja e vetme për IPF është transplantimi i mushkërive, por më pak se 5% të pacientëve kanë transplantim, dhe rezultati i tranplantimit tek IPF është shumë me i keq në krahasim me sëmundjet tjera.

Deri në vitin 2011, nuk kanë ekzistuar ilaçe te aprovuara per pacientët me IPF. Sot për fat ekziston ilaç i cili është në dispozicion edhe në shtetin tonë dhe ka për qëllim zvogëlimin e simptomeve dhe ngadalsimin e procesit të përkeqsimit të sëmundjes, duke mundësuar që personat me IPF ta ruajnë pamvarësine e tyre dhe ta jetojnë jetën ashtu siç duan vetë.

Çdo fryme është e rëndësishme.